



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republike of Kosovo  
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality  
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

**KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH**

Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, dhe nenin 9, paragrafi 1, pika 7, të Udhëzimit Administrativ, Nr-27/2012, të nxjerr nga MPB-ja dhe Nr-03/2012, të nxjerr nga MAPL-ja me datën 22.08.2012, pas propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.01.2026 miraton këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

**MIRATOHET** Raporti Vjetor i Punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2025.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti Punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën janar-dhjetor 2025, i hartuar nga Koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi z. Adem Emini, në bashkëpunim me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe i miratuar nga Kuvendi i Komunës në Dragash.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës njëherit Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

**Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Dragash, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në web-faqën zyrtare të Komunës.

01Nr. 060/01-934-4/26

Datë 27.01.2026

Kryesuesi i Kuvendit

Resul Fetahu



## RAPORTI

### I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

#### Janar - Dhjetor 2025

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit për themelimin e KKSB-së, Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neni 9 paragrafi 1.8, planit të punës së KKSB-së, kryetari i Komunës ju njofton për aktivitetet si në vijim:

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i ka mbajtur 6 takime të rregullta sipas dispozitave ligjore dhe planit të punës së KKSB-së për vitin 2025, ku kanë marrë pjesë në shumicën e takimeve të gjithë anëtarët e KKSB-së, ndërsa kryesuesi i KKSB ka marr pjesë në të gjitha takimet.

Gjatë këtyre takimeve është diskutuar:

#### Takimi i – I –

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga takimi i VI-të për vitin 2024,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Dragashit – duke përfshirë edhe festat e fund vitit,
3. Analizë e sigurisë në territorin e komunës së Dragashit për vitin paraprak, siguria në trafik si dhe veprimet dhe masat për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Dragashit,
4. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimi i Planit për Siguri në Shkolla,
5. Të ndryshme.....

#### Takimi i –II-

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga takimi i I-rë,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë, çështjet politike dhe të sigurisë gjatë 3 mujorit të I-rë, veprimet dhe masat për luftimin e shkelësve të ligjit si dhe masat për shkelësit e ligjit në komunikacion në komunën e Dragashit,
3. Trotuaret, liri i tyre dhe shenjat sinjalizuese,
4. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në Shkolla,
5. Të ndryshme.

### **Takimi i –III-**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga takimi i –II-të,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë, përfshirë çështjet politike dhe të sigurisë gjatë tremujorit të dytë, veprimet dhe masat e ndërmarra për luftimin e shkelësve të ligjit, si dhe masat e ndërmarra ndaj shkelësve të rregullave të komunikacionit në Komunën e Dragashit
3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin e zjarreve gjatë sezonit veror dhe shtimi i marave të sigurisë,
4. Diskutim lidhur me funksionimin e rrugës njëkahore (Unaza e Qytetit) gjatë periudhës së fluksit të mërgimtarëve,
5. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimi i planit për siguri në shkolla,
6. Të ndryshme.

### **Takimi –IV-**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga takimi i III-të,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë, çështjet politike dhe të sigurisë mes dy takimeve, veprimet dhe masat për luftimin e shkelësve të ligjit si dhe masat për shkelësit e ligjit në komunikacion në komunën e Dragashit,
3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
4. Shqyrtimi i kërkesës së qytetarëve së fshatit Globoçicë
5. Të ndryshme.

### **Takimi –V-**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga takimi i IV-të,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë dhe sigurisë në trafik në territorin e Komunës së Dragashit,
3. Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga prerja ilegale,
4. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
5. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje,
6. Të ndryshme.

### **Takimi –VI-**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Dragashit për vitin 2025,
3. Raporti me shkrim për vitin 2025 për punët dhe aktivitetet nga Komandanti i Stacionit Policor në Dragash z. Shaqir Uka,

4. Raporti me shkrim për vitin 2025 për punët dhe aktivitetet nga Komandanti i Policisë Kufitare – z. Sahit Hoti,
5. Raporti me shkrim për punët dhe aktivitetet për vitin 2025 nga Drejtori i DKA-së z. Zeni Krasniqi,
6. Raporti me shkrim për punët dhe aktivitetet për vitin 2025 nga znj. Lindita Kozmaqi – Piraj,
7. Njoftimi për përgatitjet dimërore dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonit dimëror,
8. Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike,
9. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
10. Të ndryshme.

### **Gjendja e sigurisë në Komunën e Dragashit – Viti 2025**

Gjatë vitit 2025, Komuna e Dragashit ka pasur një situatë të qëndrueshme dhe të kontrolluar të sigurisë. Në tërë territorin e Komunës është ruajtur rendi dhe qetësia publike, ndërsa edhe në gjashtëmujorin e parë të këtij viti nuk janë evidentuar zhvillime që do të cenonin stabilitetin politik apo sigurinë e përgjithshme.

Vlerësime pozitive për gjendjen e sigurisë janë dhënë nga institucionet kompetente shtetërore, si dhe nga mekanizmat monitorues që kanë ndjekur nga afër punën e Këshillit Komunal për Siguri përmes takimeve të rregullta dhe raporteve përkatëse.

Ky vlerësim mbështetet kryesisht në funksionimin normal të marrëdhënieve ndëretnike, garantimin e lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët dhe mungesën e incidenteve serioze që do të kishin ndikim në stabilitetin e përgjithshëm të Komunës. Rastet sporadike dhe të izoluara që janë shënuar nuk kanë prodhuar pasoja në klimën e përgjithshme të sigurisë.

Në këtë kontekst, Komuna e Dragashit është vlerësuar pozitivisht edhe në raportet e institucioneve të sigurisë në nivel rajonal dhe qendror, si dhe gjatë komunikimeve dhe takimeve të zhvilluara me misionet ndërkombëtare si KFOR-i, OSBE-ja dhe organizata të tjera vendore e ndërkombëtare, të cilat kanë monitoruar situatën e sigurisë në këtë komunë multietnike dhe kufitare, e pozicionuar në hapësirën kufitare Kosovë–Shqipëri–Maqedoni e Veriut.

Gjatë periudhave të pushimeve verore dhe dimërore të vitit 2025, Komuna ka regjistruar një rritje të ndjeshme të numrit të bashkatdhetarëve nga diaspora. Pavarësisht këtij fluksi, të dhënat zyrtare nga institucionet përkatëse tregojnë se nuk ka pasur raste që do të rrezikonin rendin publik apo sigurinë e përgjithshme.

Veçanërisht gjatë muajve korrik dhe gusht 2025, pas vënies në funksion të rrugës unazore me qëllim të lehtësimit dhe përmirësimit të qarkullimit rrugor, është evidentuar menaxhim i suksesshëm i komunikacionit. Ky zhvillim është vlerësuar pozitivisht nga Policia e Kosovës dhe nga subjektet ekonomike që veprojnë në atë zonë, duke u siguruar qarkullim i pandërprerë dhe pa bllokime.

## **Siguria në institucionet arsimore**

Në institucionet arsimore të Komunës së Dragashit, niveli i sigurisë gjatë vitit 2025 ka qenë i kënaqshëm. Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndërmarrë masa të vazhdueshme për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për nxënësit dhe stafin arsimor.

Me vendim të Kryetarit të Komunës, gjatë pushimeve verore, oborret e shkollave janë vënë në dispozicion për parkimin e automjeteve të mërgimtarëve, pa u shënuar incidente apo dëmtime.

Bashkëpunimi ndërinstitutional me Policinë e Kosovës ka qenë funksional dhe i vazhdueshëm. Në këtë kuadër, janë mbajtur takime të rregullta me drejtuesit e DKA-së dhe të institucioneve arsimore, si dhe janë realizuar aktivitete informuese dhe edukative nëpër shkolla, me fokus në sigurinë e përgjithshme, parandalimin e dukurive negative dhe sigurinë në komunikacion. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë edhe ekspertë të fushave përkatëse, përfshirë ekspertë të narkotikëve dhe të trafikut rrugor. Aktivitetet edukative janë mbështetur edhe nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK).

### **Të dhënat statistikore të Policisë nga stacionit policor në Dragash po i paraqesim në mënyrë tabelore si më poshtë për periudhën Janar – Dhjetor 2025:**

Raste të Inicuara	<b>248</b>
Vepra Penale	<b>167</b>
Vjedhje	<b>9</b>
Vjedhje e rëndë	<b>9</b>
Tentim vetëvrasje	<b>1</b>
Dhuna në familje	<b>16</b>
Aksidente të Trafikut	<b>55</b>
Dënime në Trafik	<b>3268</b>

## Qarkullimi përmes SPK-ve.

### Qarkullimi përmes SPK në periudhën Janar -Dhjetor 2025

Informata për Hyrje - Dalje të Personave dhe Automjeteve: 01/01/2025-16/12/2025				
Pikat e kalimit kuifitar me shtete fqinje	Pasagjerë të kontrolluar		Automjete të kontrolluara (veturat)	
	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje
Oqrush	5302	4751	0	0
Shishtavec	0	0	0	0
Borje	31090	28310	12447	11402
Restelicë	355	828	134	262
<b>Totali</b>	<b>36747</b>	<b>33889</b>	<b>12581</b>	<b>11664</b>
<b>Totali</b>	<b>70636</b>		<b>24245</b>	
<b>Muaji raportues Janar Dhjetor 2024</b>				
<b>Persona në hyrje</b>	<b>Persona në dalje</b>	<b>Automjete në hyrje</b>	<b>Automjete në dalje</b>	
<b>39713</b>	<b>36044</b>	<b>12537</b>	<b>11541</b>	
<b>75757</b>		<b>24078</b>		

Bazuar në vlerësimet e dala nga takimet e Këshillit, konkluzioni i përgjithshëm ka qenë se situata politike dhe e sigurisë, e trajtuar në tërësinë e saj, ka qenë e qëndrueshme dhe në nivel të kënaqshëm. Gjatë kësaj periudhe është garantuar liria e plotë e lëvizjes së qytetarëve në të gjithë territorin e Komunës, ndërsa institucionet komunale dhe shtetërore kanë funksionuar në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa. Nuk është evidentuar asnjë zhvillim apo situatë që do të ndikonte ndjeshëm në përkeqësimin e gjendjes së përgjithshme politike, të sigurisë apo në funksionimin normal të pushtetit lokal.

Duhet theksuar se në takimet e Këshillit, përveç anëtarëve të rregullt, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave monitoruese, të cilët janë pritur si pjesëmarrës të mirëpritur në cilësinë e vëzhguesve. Në këtë kuadër, kanë qenë të pranishëm përfaqësues të OSBE-së (OSCE), të ministrive përkatëse, përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, të cilat janë njoftuar me kohë për datat dhe agjendat e takimeve, si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe mediave të interesuara.

Në frymën e bashkëpunimit, tolerancës dhe dialogut konstruktiv, gjatë këtyre takimeve janë trajtuar dhe inicuar edhe çështje të tjera me rëndësi për qytetarët, Komunën dhe funksionimin efektiv të Këshillit, në përputhje me sugjerimet e anëtarëve dhe rekomandimet e pjesëmarrësve monitorues.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të tij, Këshilli ka shqyrtuar edhe çështje të tjera që kanë dalë si nevojë e momentit, apo që janë iniciuar nga anëtarët e Këshillit dhe nga pjesëmarrësit e pranishëm, të cilët kanë ndjekur dhe kontribuar në mënyrë aktive në punën e Këshillit.

Duke u mbështetur në këtë gjendje dhe në rëndësinë që ka ruajtja dhe avancimi i sigurisë, në periudhën e ardhshme paraqitet nevoja për rritje të përgjegjësisë institucionale. Kjo nënkupton që secili subjekt komunal, organ shtetëror dhe anëtar i Këshillit të veprojë në përputhje me dinamikën e punës së Këshillit, duke treguar përgjegjësi të plotë në iniciimin e çështjeve relevante dhe në përmbushjen e obligimeve ligjore që lidhen me sigurinë e qytetarëve, në të gjitha mjediset e Komunës ku paraqitet nevoja për veprim dhe angazhim.

01Nr. 060/01-934-4/26  
Datë 27.01.2026

Kryesuesi i Kuvendit  
  
Resul Fetahu

